



Institute
for Democracy
and Mediation

Nga rekomandimi në veprim: Kapërcimi i pengesave në zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së

Dr. Rovena Sulstarova
Diori Angjeli

Hyrje

Në çdo demokraci kushtetuese, institucionet e pavarura luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e kontrollit dhe ekuilibrave. Në Shqipëri, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) është institucioni më i lartë mbikëqyrës për çështjet financiare dhe administrative në institucionet publike, i cili në të njëjtën kohë ofron rekomandime për institucionet publike, qeverinë qendrore, autoritetet vendore, dhe ndërmarrjet publike apo shoqëritë aksionere, ku shteti zotëron 50%+1 të aksioneve. KLSH ka gjithashtu një mandat të qartë kushtetues për të mbikëqyruar dhe audituar përdorimin e fondeve publike, duke siguruar që ato të menaxhohen në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente.¹ Procesi sistematik i auditimit të KLSH-së përfshin:²

- **Vlerësimin e shpenzimeve:** KLSH ushtron auditim financiar dhe përputhshmërie me qëllim dhënien e një vlerësimi objektiv, të pavarur dhe të bazuar në evidenca, mbi mënyrën se si shpenzohen fondet publike, duke identifikuar shkeljet dhe mangësitë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- **Auditimin e performancës:** KLSH shqyrton ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e politikave dhe projekteve të qeverisë.
- **Raportimi:** Pas përfundimit të auditimeve, KLSH publikon raporte që përmbajnë rekomandime për përmirësim dhe masat që duhen marrë për të adresuar çështjet e identifikuara.
- **Auditimin e IT:** Në auditimet e IT-së, Kontrolli i Lartë i Shtetit mbledh dhe vlerëson provat, për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive dhe përdor burimet në mënyrë eficiente.
- **Auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve:** Përmes këtij auditimi, i cili mund jetë tematik me program të posaçëm ose i integruar si pikë e veçantë në auditimet që KLSH ushtron për institucionet, Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson nivelin e zbatimit të rekomandimeve të përcjella nga auditimi i mëparshëm.

Komisioni Evropian (KE) i është referuar rolit dhe rëndësisë së KLSH në Progres-Raportin e vitit 2024 për Shqipërinë. Në seksionin që i përket analizës së kapitullit 32 mbi “Kontrollin Financiar”, institucioni shprehet se Shqipëria ka pasur progres të limituar në këtë fushë, dhe se kontrolli financiar i brendshëm publik duhet fuqizuar më tej.³ Për sa i përket zbatimit të rekomandimeve të KLSH nga institucionet publike, që është edhe çështja kryesore e këtij dokumenti politikash, KE shprehet se ‘duhen përpjekje të mëtejshme në mënyrë që të garantohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, dhe që raportimet e kësaj të fundit të vlerësohen dhe përdoren në mënyrë kuptimplote nga Parlamenti’. Në vazhdë të kësaj, jepet si rekomandim që të vazhdohet

1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. (1998). Neni 162.

2 Ligj Nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

3 European Commission. (2024). Albania 2024 Report. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

të monitorohet dhe ndiqet implementimi i rekomandimeve të dhëna nga KLSH, dhe që të rritet shqyrtimi parlamentar mbi institucionet shtetërore, mbi implementimin që i bëjnë këto të fundit rekomandimeve të marra.

Rekomandimet e KLSH-së janë thelbësore për përmirësimin e menaxhimit të institucioneve shtetërore.⁴ Ato ofrojnë një udhëzues për institucionet publike, qeverinë dhe autoritetet lokale për të adresuar dobësitë institucionale dhe për të optimizuar proceset e punës. Nga viti 2019 deri në vitin 2022, KLSH ka dhënë një numër të konsiderueshëm rekomandimesh, të cilat ndihmojnë në forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në administratën publike. Sidoqoftë, për të arritur këtë qëllim, është e domosdoshme që këto rekomandime të zbatohen në praktikë.

Zbatueshmëria e rekomandimeve të KLSH-së dhe sfidat përkatëse

Në analizën e shifrave të masës së zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) gjatë viteve të fundit, identifikohet një dinamikë interesante. Fillimisht, vërehet se shkalla e zbatueshmërisë së rekomandimeve nga institucionet publike varion në shifra nga 49% deri në 55% (tabela 1). Kjo sugjeron se në çdo vit të caktuar, institucionet publike, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së KLSH-së, pritet të zbatojnë plotësisht ose pjesërisht rreth gjysmës së rekomandimeve të paraqitura

Tabela 1: Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve

Viti	Zbatuar/ Pjesërisht	Proces Zbatimi/ Nuk janë zbatuar	
2018 ⁵	52%	48%	(N=2885)
2019 ⁶	51%	49%	(N=2745)
2020 ⁷	55%	45%	(N=1292)
2021 ⁸	50%	50%	(N=3646)

4 Ministria e Financave. (2024). Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Publike (fq. 13). <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf>

5 Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2020). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2019. https://drive.google.com/file/d/1Sec3WhPN7z3kvSDwokclny_yOqXhOgaD/view

6 Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2021). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2020. https://drive.google.com/file/d/1_fj1G-J4IHwa7nyPBatQQgCvXOKXvk3XQ/view?usp=sharing

7 Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2022). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2021. https://drive.google.com/file/d/1-C60_4P7rDn2QE2WcOLYs1PF8TqrtJ1d/view?usp=sharing

8 Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2022. https://drive.google.com/file/d/1XZ-FR_lyBJ5dbFUzELEychi6OX8FpZX/view

2022 ⁹	49%	51%	(N=4494)
-------------------	-----	-----	----------

Më tej, kur shqyrtojmë zbatueshmërinë e rekomandimeve në varësi të natyrës së tyre, zbulohen detaje të tjera (Tabela nr. 2). Rekomandimet që shprehen në formën e masave disiplinore janë ato që gëzojnë zbatueshmërinë më të lartë, duke shënuar përqindje të larta të zbatueshmërisë në secilin nga katër vitet e analizuar. Sa i përket masave administrative, trendi i viteve të fundit tregon një zbatueshmëri të kënaqshme, e cila ka variuar në shifra nga 22% deri në 32% për vitet 2019-2021, por ka pësuar një rritje pozitive duke arritur 46% në vitin 2022.

Ndërkohë, për të pesta vitet, masat organizative duken të zbatohen në nivele nga 40% deri në 48%, duke treguar se pritshmëria për institucionet është që të zbatojnë diçka më pak se gjysmën e masave organizative të ngarkuara nga KLSH. Së fundmi, niveli i zbatueshmërisë së masave ligjore, që synojnë përmirësimin dhe ndryshimin e këtyre të fundit, tregon variacione të dukshme përgjatë viteve, ndoshta për shkak të numrit të vogël të kësaj kategorie rekomandimesh.

Tabela 2: Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve sipas llojit të rekomandimit

Viti	Përmirësime/ Ndryshime Ligjore	Organizative	Disiplinore	Administrative
2018	37% (N=19)	45% (N=1902)	76% (N=656)	49% (N=278)
2019	36% (N=36)	44% (N=2062)	64% (N=530)	32% (N=117)
2020	23% (N=13)	48% (N=990)	67% (N=243)	22% (N=46)
2021	61% (N=36)	45% (N=2699)	65% (N=828)	29% (N=83)
2022	56% (N=43)	40% (N=2909)	59% (N=581)	46% (N=93)


Nga të dhënat e mbledhura, vërehet një rënie e përqindjes së rekomandimeve të zbatuara nga viti 2020 deri në vitin 2022. Në vitin 2020, 55% e rekomandimeve ishin zbatuar, ndërsa në vitin 2021 përqindja ra në 50% për të përfunduar në vlerën 49% për vitin 2022. Kjo tendencë tregon se, ndonëse KLSH ka vazhduar të prodhojë rekomandime, zbatimi i tyre nga ekzekutivi ka pësuar një ngadalësim.

Është e rëndësishme të theksohet se viti 2020 ishte një vit me numër të vogël


9 Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2024). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2023. <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404090814030207Raporti%20i%20performances%202023%20final.pdf>

rekomandimesh të pranuar (1292) në krahasim me vitet 2021 (3646) dhe 2022 (4494). Kur analizojmë trendet e zbatueshmërisë sipas kategorive (Figura 2), vërehet një rritje për masat ligjore, me një kulm në vitin 2021, që tregon një përmirësim të konsiderueshëm në zbatueshmërinë e tyre.

Ndërkohë, niveli i zbatueshmërisë për masat organizative dhe disiplinore ka mbetur relativisht konstant gjatë këtyre viteve. Megjithatë, masat administrative tregojnë një rënie të dukshme të zbatueshmërisë, me nivelin më të ulët në vitin 2020, pasuar nga një rritje në 46% për vitin 2022. Kjo edhe për arsyen se për masat administrative të lëna nga KLSH, subjekti i audituar nuk është përgjegjës për zbatimin e tyre, por institucioni që ka tagrin dhe atributet ligjore për marrjen e masave administrative. P.sh, në rastin e shkeljeve në prokurimet publike, KLSH i rekomandon Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, me qëllim marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, ndaj punonjësve përgjegjës, sipas rolit të tyre në procedurë.¹⁰ Këto variacione sugjerojnë nevojën për një vlerësim të mëtejshëm mbi efektivitetin e zbatimit të rekomandimeve, veçanërisht për masat administrative.



10 Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2017). Raport Përfundimtar Auditimi: Auditim Përputhshmërie. <https://panel.klsh.org.al/storage/phpAu5pHV.pdf>



Shifrat tregojnë se pavarësisht numrit në rritje të rekomandimeve dhe sasisë së tyre që zbatohen nga institucionet përgjatë viteve të fundit, ka një ngecje në përqindjen e zbatueshmërisë. Ruajta e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në nivelet midis 49% dhe 55% tregon se ekzistojnë sfida të dukshme që pengojnë përmirësimin e këtij procesi. Disa prej sfidave të identifikuara, janë si më poshtë:

- **Mungesa e burimeve në institucionet publike.** Një nga sfidat kryesore që hasin institucionet e qeverisjes qendrore është mungesa e burimeve njerëzore, kapaciteteve teknike, si edhe buxhetet e kufizuara. Shumë institucione shpesh operojnë me staf të pamjaftueshëm dhe nuk kanë trajnimet e nevojshme për të zbatuar rekomandimet e KLSH-së. Kur institucionet nuk disponojnë buxhete të mjaftueshme dhe staf të trajnuar, vështirësitë për të zbatuar ndryshimet e nevojshme rriten, duke çuar në bllokim të procesit. Kjo situatë krijon një ngarkesë të madhe pune dhe vështirësi për t'u përqendruar në zbatimin e rekomandimeve, duke minuar kështu efektivitetin e auditeve.¹¹ Përveç kësaj, perceptimi i rekomandimeve si sugjerime dhe jo si detyrime nga ana e zyrtarëve mund të ndikojë në angazhimin e ulët për zbatimin e tyre. Kjo krijon një atmosferë ku rekomandimet nuk merren seriozisht, duke ruajtur statusin aktual të praktikave administrative dhe duke penguar përparimin e nevojshëm në reformimin e proceseve të qeverisjes.
- **Hartimi i rekomandimeve nga KLSH që adresojnë pasojën dhe jo shkakun:** Qëllimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja është që të përmirësojë sistemin e menaxhimit financiar. Në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit, rekomandimi duhet të adresojë shkakun ose thënë ndryshe “pse-në” që ka krijuar

11 Dhoga, N. & Sulstarova, R. (2023) Integrity in central government institutions: opportunities, challenges, and the way forward. Institute for Democracy and Mediation. <https://idmalbania.org/sq/dokument-politikash-revolucioni-digjital-vleresimi-i-vendimit-te-qeverise-se-shqiperise-per-te-kaluar-tek-ofrimi-i-sherbimeve-vetem-online>

këtë mangësi.¹²Në repertorin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, megjithëse janë bërë përmirësime, vijojnë ende të ketë rekomandime që adresojnë pasojën, duke bërë që gjetjet e konstatuara në një vit buxhetor, të jenë të së njëjtës natyre me gjetjet e vitit pasardhës.

- **Mbikëqyrje e ulët Parlamentare:** Një sistem i dobët monitorimi dhe vlerësimi mund të kontribuojë në rënien e nivelit të zbatimit të rekomandimeve. Kur nuk ka mekanizma të qartë për ndjekjen e progresit të zbatimit, institucioneve u mungon motivimi për të zbatuar rekomandimet. Në këtë kontekst, parlamenti ka një rol thelbësor në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe ekzekutivit, përmes kërkesës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.¹³ Funkzioni mbikëqyrës i Parlamentit përfshin disa aspekte të rëndësishme:
 - Monitorimi i raporteve: Parlamenti shqyrton raportet e KLSH-së dhe rekomandimet e saj. Komisionet përkatëse janë përgjegjëse për të analizuar këto raporte dhe për të siguruar që rekomandimet do të merren parasysh nga ekzekutivi. Megjithatë, Parlamenti shpesh nuk angazhohet mjaftueshëm në mënyrë aktive për të monitoruar zbatimin e këtyre rekomandimeve. Mungesa e diskutimeve të rregullta dhe të detajuara mbi raportet e KLSH-së e bën të vështirë që rekomandimet të marrin vëmendjen dhe përparësinë e nevojshme.
 - Kërkesa për llogaridhënie: Nëse ekzekutivi dështon në zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, Parlamenti ka detyrimin të kërkojë llogaridhënie. Kjo përfshin zhvillimin e seancave dëgjimore me institucionet e audituara dhe diskutimin e përgjegjësisë për moszbatimin e rekomandimeve.

Për më tepër, roli i nënkomisionit të ri parlamentar për auditimin e sektorit publik është kritik në këtë kontekst, pasi ai mund të ofrojë një platformë më të strukturuar dhe të fokusuar për të adresuar çështjet e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies. Ngritja e këtij nënkomisioni përmirëson potencialin e Parlamentit për të ushtruar një mbikëqyrje më të efektshme mbi institucionet publike dhe për të siguruar që rekomandimet e KLSH-së të zbatohen në praktikë. Kjo strukturë, duke ruajtur pavarësinë e KLSH-së, mund të ndihmojë në përmirësimin e mënyrës se si rekomandimet e auditimeve trajtohen dhe zbatohen në praktikë.

- **Ndikimi i aktorëve politikë në pavarësinë e KLSH:** Një nga sfidat kryesore me të cilat përballlet Kontrolli i Lartë të Shtetit (KLSH) është politizimi, një faktor që e dobëson pavarësinë e saj. Kreu i KLSH emërohet me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, i cili është shumë i polarizuar. Ekzekutivi, që ka shumicën e vendeve në parlament, kontrollon gjithashtu buxhetin e institucioneve të pavarura. Kjo situatë ngre pyetje mbi mënyrën se si kreu i KLSH-së dhe kryetarët e institucioneve të tjera të pavarura mund të ruajnë pavarësinë e tyre nga ndikimi i ekzekutivit.

12. Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2016). Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. <https://panel.klsh.org.al/storage/php-FaW6UR.pdf>

13 National Democratic Institute. (2023). Strengthening the Role of Albanian Parliament in Curbing Corruption. <https://www.ndi.org/publications/strengthening-role-albanian-parliament-curbng-corruption>

Presionet politike dhe interesat e partive mund të pengojnë Parlamentin në funksionin e tij mbikëqyrës, duke dëmtuar kështu procesin e llogaridhënies ndaj institucioneve që janë subjekt i KLSH. Kjo sfidë kërkon një qasje të koordinuar për të forcuar pavarësinë e KLSH-së dhe për të siguruar që ajo të jetë në gjendje të ushtrojë funksionet e saj pa ndërhyrje politike.

- **Koordinim i dobët midis KLSH-së dhe institucioneve:** Ky është një faktor i rëndësishëm i cili ka potencialin të shkaktojë keqkuptime mbi rëndësinë dhe qëllimet e rekomandimeve. Kur dialogu është i dobët, zyrtarët mund të mos kuptojnë plotësisht qëllimin dhe vlerën e shtuar të këtyre rekomandimeve, duke e bërë më të vështirë angazhimin në zbatimin e tyre. Gjithashtu, komunikimi i dobët përgjatë fazës së monitorimit mund të pengojë ndjekjen e progresit, duke e bërë të vështirë për institucionet të ndihen përgjegjëse për zbatimin.

Rekomandime

Për të përmirësuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), është e domosdoshme të adresohen sfidat ekzistuese që pengojnë procesin e mbikëqyrjes dhe zbatimit. Rekomandimet që pasojnë synojnë të forcojnë kapacitetet e institucioneve, të rrisin transparencën dhe llogaridhënien, si dhe të krijojnë një bashkëpunim më efektiv me KLSH dhe Parlamentin. Këto hapa janë esenciale për të siguruar që rekomandimet e KLSH-së të zbatohen me sukses, duke kontribuar kështu në një administratë publike më të përgjegjshme dhe efektive.

- **Forcimi i Kapaciteteve Teknike:** Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të investojnë në burime njerëzore dhe trajnime të specializuara për stafin e tyre. Kjo do të ndihmojë në rritjen e aftësive për të zbatuar rekomandimet e KLSH-së në mënyrë më efektive, duke reduktuar ngarkesën e punës dhe duke rritur efektivitetin e auditimeve. Gjithashtu ndërgjegjësimi i punonjësve të institucioneve publike mbi rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH.
- **Përmirësimi i hartimit të rekomandimeve nga KLSH, në formë dhe përmbajtje:** Në hartimin e rekomandimeve duhet të merren parasysh dy këndvështrime. Së pari, këndvështrimi i subjektit të audituar, nëse është mjaftueshëm i qartë për rekomandimin dhe masat që duhet të ndërmerren për zbatimin e tij. Së dyti, këndvështrimi i KLSH-së që rekomandimi është hartuar në mënyrë të tillë që e bën lehtësisht verifikimin e zbatimit të tij. Në këtë kontekst, shkrimi i një rekomandimi të qartë, konciz dhe që adreson shkakun merr një rëndësi të veçantë, pasi inkurajon subjektin për të rritur zbatueshmërinë dhe nga ana tjetër i mundëson KLSH-së rritjen e impaktit auditues.
- **Rritja e Bashkëpunimit me Parlamentin dhe forcimi i rolit të këtij të fundit:** Krijimi i një marrëdhënieje më të ngushtë dhe të rregullt midis institucioneve të qeverisjes qendrore dhe komisioneve parlamentare është thelbësor për një monitorim më të mirë të zbatimit të rekomandimeve. Një bashkëpunim i tillë do të sigurojë që rekomandimet të marrin vëmendjen dhe përparësinë që

meritojnë. Në këtë kontekst, ngritja e nënkomisionit “Për Auditimin e Sektorit Publik” në Kuvend është një hap i rëndësishëm. Ky nënkomision do të ndihmojë në forcimin e mbikëqyrjes parlamentare, duke lehtësuar diskutimet mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe duke siguruar llogaridhënie nga ekzekutivi. Parlamenti duhet të angazhohet aktivisht për të kërkuar llogaridhënie nga ekzekutivi kur rekomandimet e KLSH-së nuk zbatohen. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e seancave dëgjimore për të diskutuar dhe analizuar arsyet e moszbatimit.

- **Sigurimi i pavarësisë së KLSH nga influenca e aktorëve politikë:** Institucioni i KLSH duhet të sigurojë pavarësinë nga politizimi dhe influenca dëmtuese e aktorëve politikë përmes një qasjeje strikte në nivel strukturor dhe operacional. Kjo duhet të arrihet përmes emërimeve transparente dhe meritokratike në rradhët e institucionit, garanci të qarta ligjore, dhe mekanizma të përmirësuar llogaridhënieje që shmangin interferencat e aktorëve politikë. Në këtë mënyrë, sigurohet që aktiviteti i KLSH është asnjans dhe tërësisht i bazuar mbi standarde profesionale.
- **Përmirësimi i komunikimit të KLSH me institucionet:** Një komunikim më proaktiv dhe i qartë midis KLSH dhe institucioneve subjekte të saj, do të përkthehet në një bashkëpunim më të efektshëm, pajtueshmëri më të lartë dhe transparencë të përmirësuar. Ky komunikim do t’i ndihmonte institucionet e audituara që të kuptonin më mirë pritshmëritë e KLSH ndaj tyre, duke rregulluar qasjen e këtyre të parëve ndaj problematikave të identifikuara dhe rekomandimeve të lëna. Një aspekt i rëndësishëm është gjithashtu përmirësimi i qartësisë dhe kuptueshmërisë së rekomandimeve të KLSH-së, sidomos ato që lidhen me auditimet. Këto rekomandime shpesh janë të gjata dhe komplekse, duke kërkuar që të formulohet një vlerësim më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë për institucionet. Kjo do të ndihmojë që zyrtarët të kuptojnë më mirë qëllimet e rekomandimeve dhe të angazhohen në zbatimin e tyre në mënyrë më efektive
- **Rritja e bashkëpunimit me Shoqërinë civile dhe partnerë të huaj:** Organizimi i tryezave të përbashkëta mes KLSH-së, shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore ofron një platformë komunikimi efektive për diskutime konstruktive me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Ky bashkëpunim do të inkurajojë ndarjen e ideve dhe praktikave më të mira, si dhe do të angazhojë ekspertë ndërkombëtarë që mund të kontribuojnë me njohuri dhe mbështetje. Në këtë mënyrë, do të krijohet një ekosistem më i fortë për llogaridhënie dhe transparencë, duke ndihmuar në përmirësimin e praktikave të menaxhimit financiar në administratën publike.

Zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së është një indikator i rëndësishëm për funksionimin e shëndetshëm të institucioneve të pavarura dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj qytetarëve. Ndërsa numrat nuk tregojnë ndonjë rritje në nivelin e zbatimit të këtyre rekomandimeve nga ana e institucioneve publike në vend, është e nevojshme që të gjithë aktorët e përfshirë të punojnë së bashku për të rikthyer besimin në procesin e kontrollit dhe mbikëqyrjes në administratën publike. Vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet një qeveri e përgjegjshme dhe transparente për

qytetarët shqiptarë, si dhe ndërtohet një sistem më i fortë i kontrollit dhe balancës në Shqipëri.

Bibliografia

- Dhoga, N. & Sulstarova, R. (2023) Integrity in central government institutions: opportunities, challenges, and the way forward. Institute for Democracy and Mediation.
- European Commission. (2024). Albania 2024 Report.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2016). Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2017). Raport Përfundimtar Auditimi: Auditim Përputhshmërie.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2020). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2019.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2021). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2020.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2022). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2021.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2022.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2024). Raporti Vjetor i Performancës për Vitin 2023.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. (1998). Neni 162.
- Ligj Nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”
- Ministria e Financave. (2024). Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Publike
- National Democratic Institute. (2023). Strengthening the Role of Albanian Parliament in Curbing Corruption